

## Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik – Universiteti i Prishtinë
Titulli i lëndës:	Historia e shtetit dhe e së drejtës shqiptare
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	I – Semestri II
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Kati i IV, Kabineti nr. 13
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Fatmir Sejdiu, Mr. Emine Abdyli, Mr. Xhafer Tahiri
Detajet kontaktuese:	Email: fatsej@hotmail.com
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	Lënda <i>“Historia e shtetit dhe e së drejtës shqiptare”</i> do të përfshijë periudhën e zhvillimit prej shtetit dhe të drejtën në Iliri e deri në periudhën e Ahmet Zogut. Ndërmjet këtyre fazave të zhvillimit do të fokusohet në shtetin dhe të drejtën në Epir, Principatat Feudale Shqiptare, shtetin dhe të drejtën në kohën e Skënderbeut, Pashallëqetë shqiptare, burimet e së drejtës shqiptare me fokus të veçantë në Kanunet shqiptare të cilat një kohë të gjatë kanë luajtur rol të rëndësishëm shoqëror, lidhjen shqiptare të Prizrenit, shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë 1912, rimëkëmbjen e shtetit shqiptarë, shtetin dhe të drejtën në periudhën e Ahmet Zogut etj. Në kuadër të këtyre periudhave do të flitet si për rregullimet shtetërore ashtu edhe për funksionimin e së drejtës në tërësi.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	
	E gjithë materia e kësaj lënde, e cila prezantohet para studentëve, qoftë nëpërmjet ligjëratave apo edhe ushtrimeve, seminareve dhe formave të tjera të punës me ta, ka për qëllim që studentët të pajisen me njohuri të përgjithshme të kulturës juridike si dhe me elementet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me zhvillimin e institucioneve juridike dhe shtetërore shqiptare përgjatë etapave të ndryshme historike, duke filluar nga periudhat më të hershme e deri në bashkëkohësi. Historia e institucioneve juridike dhe shtetërore shqiptare si lëndë e veçantë, pavarësisht se është

	zgjedhore, do të shërbejë për studentët që të kompletojnë njohuritë e tyre nga fusha e zhvillimeve më të rëndësishme shqiptare përgjatë historisë.		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Pas përvetësimit me sukses të kursit, studenti do të : <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të aftësohen për historinë nacionale të institucioneve juridike dhe shtetërore ,</li> <li>• Të zotërojnë njohuri historike për krijimin dhe funksionimin e institucioneve juridike dhe shtetërore,</li> <li>• Të krijojnë njohuri historike prej celulave të para të shtetit shqiptar e deri më sot.</li> <li>• Të përvetësoj një pasqyrë të qartë lidhur me sistemin e së drejtës dhe funksionimin e saj prej shtetit Ilir e deri në periudhën e Ahmet Zogut</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënies të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	1/15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	1/15	15
Punë praktike	1	1/15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1/15	15
Ushtrime në teren	1	1/15	15
Kollokfiime,seminare	2	2/5	10
Detyra të shtëpisë	2	1/5	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	1/15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	2	1/5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	1/1	5
Projektet,prezentimet ,etj	10	1/1	10
<b>Totali</b>	<b>5 ECTS</b>	<b>Total</b>	<b>150</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Duke pasur parasysh numrin e madh të studentëve, si dhe fondin e orëve të paraparë në kuadër të programit të përgjithshëm mësimor në Fakultetin Juridik, si edhe më herët do të aplikojë metodën e ligjërimit duke e vënë në funksion edhe metodën interaktive, përkatësisht bashkëbisedimit dhe komentimeve të		

	<p>nevojshme me studentët.</p> <p>Po kështu, për tematika të caktuara dhe që janë me interes të veçantë studentët do të angazhohen në përgatitje dhe prezantim të seminareve apo eseve të ndryshme dhe do të diskutohet rreth tyre.</p> <p>Orët e ushtrimeve sipas nevojës mbahen nga bashkëpunëtorët (asistentët) sipas orarit që parasheh fakulteti.</p>														
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p>Nota përfundimtare në këtë lëndë do të përcaktohet si vijon:</p> <p>10% - Pjesëmarrja aktive (nëpërmjet të diskutimeve) në ligjërata dhe në ushtrime</p> <p>10% - Prezantimi gojor</p> <p>10% - Një ese prej pesë faqesh e dorëzuar para prezantimit gojor (në të njëjtën temë)</p> <p>30% - Kollokiumi</p> <p>40% - Provimi final</p> <table border="1" data-bbox="716 953 1382 1213"> <thead> <tr> <th>Vlerësimi ne %</th> <th>Nota përfundimtare</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>91-100</td> <td>10 (dhjetë)</td> </tr> <tr> <td>81-90</td> <td>9 (nëntë)</td> </tr> <tr> <td>71-80</td> <td>8 (tetë)</td> </tr> <tr> <td>61-70</td> <td>7 (shtatë)</td> </tr> <tr> <td>51-60</td> <td>6 (gjashtë)</td> </tr> <tr> <td>0-50</td> <td>5 (pesë)</td> </tr> </tbody> </table>	Vlerësimi ne %	Nota përfundimtare	91-100	10 (dhjetë)	81-90	9 (nëntë)	71-80	8 (tetë)	61-70	7 (shtatë)	51-60	6 (gjashtë)	0-50	5 (pesë)
Vlerësimi ne %	Nota përfundimtare														
91-100	10 (dhjetë)														
81-90	9 (nëntë)														
71-80	8 (tetë)														
61-70	7 (shtatë)														
51-60	6 (gjashtë)														
0-50	5 (pesë)														
<b>Literatura</b>															
<b>Literatura bazë:</b>	<p>Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri, grup autorësh, Tiranë, 2007;</p> <p>Historia e Popullit Shqiptar I dhe II, "Toena", Tiranë, 2002;</p> <p>A.Luarasi. Shteti dhe e drejta shqiptare në epokën e Skënderbeut, Tiranë 1998.</p>														
<b>Literatura shtesë:</b>	<p>A.Luarasi, Akte juridike për historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri, I, II Tiranë, 1999.</p> <p>I.Elezi, E Drejta zakonore e Labërisë (në rrafshin krahasues), Tiranë 2003.</p> <p>Xhemal Meçi, Kanuni i Lekë Dukagjinit (Varinati I Pukës), Tiranë, 1997.</p> <p>Dom F. Illia, Kanuni i Skënderbeut, Milot, 1993.</p> <p>Studentët mund të shfrytëzojnë edhe literaturë tjetër</p>														

	plotësuese, e cila lidhet me probleme të përgjithshme juridike – historike, si edhe ato të historisë politike etj.
<b>Plani i dizejnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Shteti dhe e drejta në Iliri. Lindja dhe zhvillimi historik i shtetit Ilir; Organizimi shtetëror; E drejta Ilire. Shteti dhe e drejta në Epir; Organizimi shoqëror parashtetëror dhe lindja e shtetit në Epir; Organizimi shtetëror; E drejta në Epir. Mbretëria e Dardanisë, karakteristikat e zhvillimit të përgjithshëm shtetëror e juridik.
<b>Java e dytë:</b>	Institucionet politike dhe juridike në tokat shqiptare gjatë shek. V – XII. Tokat shqiptare në kohët e para të sundimit bizantin; Lufta politike në tokat shqiptare gjatë shek.V – VII; Organizimi ekonomik e shoqëror i sistemit të bashkësive të lira (shek. VII-VIII); Organizimi ekonomik e shoqëror në periudhën e feudalizmit të hershëm (shek. IX- XII); E drejta bizantine në tokat shqiptare në shek. IX-XII; Sistemi administrative i Bizantit në tokat shqiptare në shek.IX – XII.
<b>Java e tretë:</b>	Principatat feudale shqiptare të shek. XII – XV; Krijimi i principatave feudale shqiptare; Organizimi ekonomiko-shoqëror në Arbëri gjatë shek.XII-XV; Organizimi shtetëror dhe e drejta në principatat feudale shqiptare; Qytetet shqiptare në mesjetë dhe organizimi i tyre politik.
<b>Java e katërt:</b>	Shteti i pavarur shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut; Krijimi i shtetit shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut; Organizimi politik në shtetin e Skënderbeut; Shteti i Skënderbeut në marrëdhëniet ndërkombëtare; E drejta në shtetin e Skënderbeut. Diskutim me studentë lidhur me temat e ligjëruara. Caktim i temave të seminareve.
<b>Java e pestë:</b>	Pashallëqet feudale shqiptare; Karakteri i pashallëqeve; Pashallëku i Shkodrës; Institucionet shtetërore dhe e drejta. Pashallëku i Janinës; institucionet shtetërore dhe e drejta.
<b>Java e gjashtë:</b>	E drejta zakonore shqiptare; Burimet dhe parimet e saj kryesore; Marrëdhëniet familjare; Marrëdhëniet e pronësisë dhe detyrimet; E drejta zakonore penale; Procedura gjyqësore.
<b>Java e shtatë:</b>	Lidhja Shqiptare e Prizrenit (LSHP); Formimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit; Evolucioni i idesë së autonomisë; Realizimi faktik i autonomisë; Organizimi gjyqësor në kohën e Lidhjes Shqiptare të

	Prizrenit; Karakteristikat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe rëndësia e saj historike.
<b>Java e tetë:</b>	Shteti i pavarur shqiptar në vitet 1912-1914; Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë dhe krijimi i Qeverisë Kombëtare të Vlorës; Qeveria Kombëtare e Vlorës dhe organizimi i aparatit shtetëror; Problemi i shtetit shqiptar në politikën e fuqive të mëdha; Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit; Shteti shqiptar nën Vidin dhe Statuti organik i Shqipërisë.
<b>Java e nëntë:</b>	Rimëkëmbja e shtetit shqiptar dhe përpjekjet për demokratizimin e tij 1920-1924; Kongresi i Lushnjës dhe vendimet për rimëkëmbjen e shtetit kombëtar shqiptar. Statuti i Lushnjës; Statuti i zgjeruar i Lushnjës; Revolucioni i qershorit 1924; Qeveria e Fan Stilian Nolit;
<b>Java e dhjetë:</b>	Shteti dhe e drejta në kohën e Ahmet Zogut; Organizimi shtetëror në Republikën e vitit 1925-28; Faza përgatitore për shpalljen e Republikës; Shpallja e Republikës; Miratimi Statutit themeltar; Organet e larta të pushtetit shtetëror të Republikës; Organizimi shtetëror në Monarkinë e vitit 1928-1929; Procedura e kalimit nga Republika në Monarki; Organet e larta të Monarkisë; Organet e ulta të administratës shtetërore; Organet gjyqësore.
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	E drejta gjatë Republikës dhe Monarkisë së Ahmet Zogut; E drejta Kushtetuese; E Drejta Administrative; E Drejta Financiare; E Drejta Penale; E Drejta Procedurale Penale; E Drejta Civile; E Drejta Procedurale Civile; E Drejta Tregtare.
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Pozita juridike dhe politike e Kosovës nën okupimin serb (1912-1914) dhe të Mbretërisë SKS gjatë viteve 1918-1941. Komiteti "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës" dhe veprimtaria e tij për çlirimin e Kosovës. Lëvizja Kaçake në Kosovë dhe karakteri i saj.
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore (1941-1945). Konferenca e Bujanit 1943/44 dhe Rezoluta e saj. Kuvendi I Prizrenit i korrikut të vitit 1945.
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Pozita juridike - kushtetuese e Kosovës sipas Kushtetutës së RFPJ 1946, Ligjit Kushtetues të vitit 1953 dhe Kushtetutës së RFPJ të vitit 1963. Pozita juridike – kushtetuese e Kosovës pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 1968 dhe 1974.
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Kollokviun në të cilin përfshihet e gjithë materia e lëndës. Gjatë ligjëratave në javët e kaluara, prezantohen edhe punimet e seminarit.

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

E gjithë puna e studentit duhet të jetë e pavarur. Studentët duhet të njihen me Kodin etik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", i cili kërkon që të gjithë, studentët dhe personeli akademik të ruajnë standardet më të larta të ndershmërisë dhe integritetit akademik. Mashtrimi, plagjiatura, gënjeshtria dhe vjedhja janë rreptësisht të ndaluara. Të gjitha shkeljet e Kodit Etik do t'i raportohen Komisionit disiplinor.